



Kuvendi i Komunës Klinë
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
01Nr 160-62557/22
Klinë, dt 21.12 /22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 31.10.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkryetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSBB-së, dhe theksoi që për arsye se kemi filluar me vonesë me mbajtjen e mbledhjeve të KKSBB-së, pra, kemi filluar në muajin maj dhe jemi të obliguar që brenda vitit t'i mbajmë gjashtë mbledhje, dhe prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Siguria në Komunën e Klinës.
4. Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda.
5. Të ndryshme.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Ne po mundohemi t'i njoftojmë të gjithë përmes koordinatores, por po shihet që pjesëmarrja nuk është e kënaqshme, por nëse jeni të pajtimit atëherë po fillojmë. Çdonjëri e keni rendin e ditës përpara, tash arsyetimin e mungesave nuk është dikush që ka dhënë ndonjë arsyetim për mungesën e sotme, shumica e kanë konfirmuar pjesëmarrjen, por nuk janë këtu.

Pika 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, nëse keni mundësi me dhanë një mendim, edhe kjo duhet të votohet, jeni për?

Të gjithë anëtarët votuan pro miratimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pika 3. Siguria në Komunën e Klinës.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Ne si mbështetje kryesore e kemi komandantin e policisë i cili na jep të dhënat, kështu që e kam të vështirë ta zëvendësojë në këtë pikë, sa i përket sigurisë nuk kemi ndonjë të dhënë që diçka ka eskaluar ose ndonjë rast që e ka marrë vëmendjen e popullatës. Policia si gjithmonë është pro qytetarëve të Komunës së Klinës dhe besojë që të gjitha punët që i kanë përsipër i kanë në kontroll. Të flas me shifra dhe statistika nuk është që është e imja, por që komandanti sot po mungon në këtë pikë, dhe ai është përgjegjësi kryesor që na ofron të dhënat dhe faktet mbi gjendjen e komunës sonë. Nëse ka dikush diçka në lidhje me këtë pikë? Po, z.Josip?

Z.Josip Dedaj: Përshëndetje Nënkryetare, përshëndetje për të gjithë, tek pika e parë arsyetimi i mungesave, ndoshta ka të bëjë edhe me mosinformimin e anëtarëve, sepse don Agim Qerkinaj, nuk është i informuar që mbledhja e KKSBB-së do të mbahet sot.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: A mund të kthej përgjigje menjëherë këtu? Ne të gjithë e kemi dokumentacionin që e kemi, na është dhënë nga ju anëtarët, në atë numër të telefonit që e ka dhënë Zotëria, kemi tentuar disa herë ta kontaktojmë nga koordinitorja, mandej kemi tentuar edhe përmes zyrës së kryetarit, e kemi thirrur disa herë dhe në rast që Zotëria e ka ndërruar numrin e telefonit është dashtë ta jap numrin shtesë, e kam edhe listën e mbledhjeve të kaluara ku email-in nuk e kanë lënë.

Z.Josip Dedaj: Sa i përket numrit, kemi mundur ta gjejmë, ka shumë njerëz që kanë mundur ta gjejnë! Ai e ka ndërruar numrin para disa muajve por që nuk e paska lënë, ai edhe ashtu sot s'ka mundur të vijë, se është një festë. Unë e telefonova dhe me tregoi që nuk vjen, por edhe që ai nuk ka pasur lajmërim që mbledhja mbahet sot.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Josip, po më gëzon fakti që e paske telefonuar, por e vërteta është kjo: ne s'kemi mundur me rënë në kontakt. A ka diçka tjetër, dikush sa i përket sigurisë?

Pika 4. Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Duke e ditur në përgjithësi moshën fëmijërore, e dimë se cila moshë i përket termit fëmijë deri në moshën e rritur. E dimë që fëmijët shpeshherë përfshihen në punë të rënda që e rrezikojnë jetën e tyre. E dimë që arsyet që shumica e fëmijëve merren me punë, janë kryesisht kushtet ekonomike, varfëria, mungesa e arsimit, qëndrimi tolerant ndaj punës së fëmijëve që e detyrojnë fëmijën të bëjnë punë që nuk ju takon moshës së tyre. Kur flasim për mungesë të arsimimit, flasim kryesisht për fëmijë që ju takojnë minoriteteve romë, ashkali dhe egjiptas, ku një pjesë e tyre janë edhe rrugëve si

lypsar. Pjesa më e rrezikshme është pjesa kur fëmijët përfshihen në punë të rënda, si p.sh., prerja e drurëve, kemi shumë raste ku punojnë edhe në kuzhina që është punë e rrezikshme, e dimë që të rinjtë kanë dalë nga Kosova dhe tash është problem edhe për të gjetur punëtorë dhe këtu janë përfshirë një sferë e fëmijëve të po kësaj moshe. Ligji i punës i lejon fëmijët prej moshës 15 deri në 18 vjet të punojnë por jo punë të rënda. Se di se sa mendoni që mund të përfshihen në këtë temë, por këtë e kemi paraparë dhe në qoftë se keni ndonjë informatë në lidhje me këtë pikë, atëherë urdhëroni nëse ka dikush të shtojë diçka?

Z.Fitim Bojaj: Përhëndetje Nënkyetare, përhëndetje të pranishëm! Fatkeqësisht nuk e kemi Komandantin, që për të dy temat më shumë kanë të bëjnë me organet kompetente, sigurinë e shtetit, ne zakonisht po i shohim ndoshta edhe po e dimë se ikja e rinisë këtu në qytet dhe më shumë po e shohim nëpër lokale-restorante, bile konkretisht e pashë një djalë në klasën e nëntë duke shërbyer si kamerier, dukej shumë i ri dhe e pyeta se në cilën klasë je dhe tha që është në klasën e nëntë, mu duk absurde një djalë aq i ri, i cili e ka të ardhmen, e ka arsimimin përpara, nuk e di se sa mundemi të kontribuojmë ne si shoqëri në këtë drejtim, mirëpo me të vërtetë po ndihemi jo mirë kur i shohim fëmijët tanë në një moshë shumë të re, në vend që të arsimohen, ta kenë një të ardhme të ndritshme, ata në moshë shumë të re i qasen punës duke harruar që jeta është e gjatë, është me sprova dhe me vështirësi, prandaj edhe vet edhe të gjithë ne duhet të vijmë në përfundim se si këta fëmijë jo në moshë kaq të re, të mos i ndjekin mësimet dhe të punojnë drejt së ardhmes së tyre.

Zv.kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, vërejtje me vend u tha dhe jo vetëm në lokale të ndryshme, aty ku vërehen por puna më e madhe dhe e rrezikshme bëhet ku ne nuk i shohim, p.sh., një fëmijë 12 vjeç i ndihmon prindit në mal, ku ne nuk mund të jemi më të dashur e më të afërt se vet prindi, mirëpo shpeshherë kushtet e këqija e detyrojnë edhe prindin që të merr një iniciativë të tillë që është e rrezikshme. Zbatimi i rregullores komunale për oraret e punës së bizneseve, rregullorja për mbrojtën e fëmijëve, kjo punë nuk kërkon buxhet por kërkon angazhim kryesisht kontrollim dhe besoj që me kontroll kishim mundur ta eliminojmë aty ku kishim vërejtje, sepse jo gjithmonë mund të dimë se ku dhe çka. Nëse ka dikush në këtë temë, apo të vazhdojmë tek pika e fundit, tek të ndryshme? Atëherë vazhdojmë tek pika e fundit.

Pika 5. Të ndryshme.

Z.Josip Dedaj: Mungesa e Komandantit me të vërtetë qenka keq, se unë nuk jam mësuar që sa vjet pa dikë të sigurisë dhe Komandanti kur e ka ditur që nuk vjen është dashë ta dërgojë zëvendësin e tij, sepse unë e di që gjatë muajit kemi pasur diçka. Por ndoshta me siguri e ka mungesën të arsyeshme.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Ato që i kemi lexuar në media po ka pasur, por unë vetëm një ta sqaroj se Komandanti e ka konfirmuar pjesëmarrjen por për ndonjë arsye nuk ka ardhur, pjesa tjetër është ajo që kemi lexuar por unë nuk mund të jap fakte ose informata, kështu që, presim deri në muajin tjetër.

Z.Josip Dedaj: Edhe në qeverisjen e mëhershme kam qenë zëri i vetëm, këtu ka qenë Elmia, Tunë Dedaj, por më s'po e shoh, po më duket që nuk po guxon për të ardhur nga kryetari apo s'di pse!

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Tunë Dedaj është zëvendësuar me kolegun tënd që e ke të ulur afër.

Z.Josip Dedaj: Ani shumë mirë, po dua të flas për rrugën e Dresnikut, të premtën jemi takuar në shkallë kur e ke përfunduar punën, kam shkuar unë duke intervenuar që e kam pasur edhe një rast në fshat edhe është dashtë me ja heq telin se thash unë kam me i bajt përgjegjësitë, e thirri vet. Kur na ra përsikaj drejtori i Urbanizmit edhe unë në gjak nuk jam me të dhe asgjë nuk i kam bërë, në qoftë se jam Josip Dedaj, kryetari i fshatit Dresnik dhe jam një ndër iniciatorët kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos, ai le të vjen në shtëpi, le të më thotë nëse ka diçka kundër meje ose në rrugë, por në komunë? Po të isha unë në vendin tënd ose të Zenun Elezaj, ai s'do të kishte ndenjur drejtor, çfarë sjellje e pavend, brutale edhe ndaj meje, e dyta lagjja "Dedaj" e kam potencuar më shumë se 100 herë edhe në takim me qytetarët edhe në KKSB, mjerisht po them për atë lagje dhe familjen Dedaj, që mbi 25 shtëpi, 56 janë me fakultet bachelor dhe duke e përfunduar për profesor doktor, ju Kuvendi Komunal keni qenë në homazhe të profesorit dhe ish-asamblistit, Tush Dedaj. Unë nuk e di a ju ka ardhur turp atë ditë shiu edhe Kryetari ka qenë edhe ti ke qenë edhe drejtorët kanë qenë, çka keni menduar kur keni hyrë e kur keni dalë në homazh, ku i latë veturat, çfarë moti ka qenë, çka kemi hequr, nuk e dini se ndoshta një pjesë nuk keni qenë si kemi shkuar në varrim, mua do t' më vinte turp me qenë në Komunë, e një lagje që prej 2018-ës, janë ndarë 65 mijë euro mjete, unë s'kisha shkuar në pame me qenë si ju, e keni gjuajtur projektin në kuadër të ministrisë, në kuadër të transitit, ju e dini çka keni bërë, por rrugë nuk ka. E keni filluar këtë rrugë, tash e keni lënë në gjysmë trotuarin se kemi probleme, me siguri që keni probleme sepse s'i keni zgjedhur me kohë, do të thotë s'keni problem me ata që e kanë tokën e vet, por keni probleme me veten, se ju është dashtë t'i rregulloni këto gjëra, trotuarin s'e ka ndalur askush, ka mundur të vazhdojë trotuari, për mos me zgjat më shumë se nuk qenka Komandanti këtu, por qenka drejtori, unë po them se si përfaqësues i fshatit Dresnik, javën e ardhshme të shkojë në zyrën e Bashkimit Evropian, të jua tregojë shtëpi për shtëpi peticionin, emrat, profesionin dhe ejani ta shihni pra rrugën në çfarë gjendje është, e dyta është se ka gjasa që do të ballafaqoheni me një protestë nga banorët e Dresnikut, që nuk kanë kanalizim, nuk kanë rrugë, nuk kanë ndriçim, nuk kanë asgjë edhe kryetari vet le të më thotë që nuk më ka premtuar, që trotuari ka për tu shtruar para vitit të ri, nuk është bërë asgjë, dhe është viti i dytë. Projekti është ndarë, por çka keni më me atë projekt, unë nuk merrem me ato gjëra, unë e di që fshati Dresnik është paralagje e Klinës, fshati më i vjetër në Kosovë, me një arkeologji që nuk e ka asnjë fshat, asnjë vend në Ballkan dhe ju e dini më mirë se unë dhe mos të ketë rrugë, unë s'dua të flas më, faleminderit.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit Josip, fole mjaft, besoj arsyeshëm.

Z.Shemsi Bajraktari: Përshëndetje, Nënkryetare, kjo është jashtë temës së KKSB-së.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Në rregull, tani e sqarojmë. Faleminderit, Josip, kërkesat dhe ankesat e qytetarëve si për ty dhe fshatin tënd, po aq më të mëdha janë në këtë ulëse ku jemi ne këtu, për ta bërë një zgjedhje më të mirë për qytetarët e komunës së Klinës, veçanërisht për shqetësimin tënd që e ke që disa herë, unë kam marr informata dhe ti e din se ku çalon problemi i asaj rruge, tjetër është që me qenë i zëshëm është shumë mirë, por edhe me qenë i arsyeshëm. Ti e the që ka kaluar në ministri dhe është një çështje pak më e komplikuar sesa e thua ti dhe që për mendimin tim thonë që bindjet nuk edukohen lehtë, është shumë vështirë ty me të bind që munda për fshatin Dresnik dhe pa dallim për fshatra

është duke u bërë pa kursyeshëm, të gjithë e dimë se çfarë shtrenjtimi dhe çfarë problemesh kanë me ndërtimtari, me punë, me kompanitë që përtojnë të fillojnë punën etj., është problem jo vetëm për Klinën, por për të gjitha Komunat. E përmende takimin me drejtorin, fakt ashtu ka qenë, mirëpo unë nuk pash asnjë sjellje të tij pos që u ndal, biseduat dhe të mori në zyrën e tij, unë e pash që u ngjitët lart, unë vazhdova poshtë dhe mendova që jeni marr vesh. Rrugën e Dresnikut e kemi parë, vërtetë është për çdo shqetësim, ngushëllime për profesorin, ka qenë një ditë e vështirë dhe ju kam thënë personave me të cilët isha, se rruga paska nevojë me të vërtetë urgjente.

Z.Josip Dedaj: T'i përgjigjem zotërisë, KKSB-ja është mbledhje e sigurisë në bashkësi dhe rruga është një ndër ato problemet e sigurisë që shkakton, e dyta unë nga ti kam shkuar te ai për një takim me kryetarin për dy minuta dhe nuk më pranoi, por në rregull, e treta më e rëndësishmja që ti po i arsyeton këtu në qoftë se për rrugën e Dresnikut është shtrenjtuar asfalti, zonja Nënkrjetare për një shtëpi ose dy shtëpi në Berkovë i ke dërguar 300 metra asfalt, për herë të katërt është duke u shtruar rruga në Volljakë, për herë të katërt është duke u shtruar në Shtupel dhe Gjurgjevik i madh, në Dresnik asnjë gjë, po them me qenë në vend tënd, shukatem, kërkoj falje.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Josip, nën një mund të diskutosh çka të duash, por gishtin e ulë, nën dy nëse ti mendon se KKSB-ja duhet të shndërrohet në arenë përplasjesh, gabon, ti duhet ta dish punën e një nënkryetari, ti nëse mendon që një nënkryetar është Kryetar, gabon. Jam përfaqësuese, më është dhënë një delegim me udhëheq dhe e udhëheqi në mënyrën më të mirë të mundshme, sa te pëlqen ty përgjigja ime ajo është relevante ty mundet me pëlqye ose jo. Në Berkovë si në çdo fshat kanë shkuar projekte, se zakonisht kur doni me ataku, atakoni në pjesën prej nga i përket, unë në familjen Tanushi i kam tri shtëpitë e para në Zllakuqan, ku rrugicat e tyre të gjitha janë të pa shtruara, me tendencë nuk jap përgjigje as nuk jap sqarime jemi ma transparent të kuptohemi.

Z.Josip Dedaj: Nuk e thash Berkovën për ndonjë arsye, unë kam dëshirë që të shtrohen të gjitha rrugët në të gjitha fshatrat e Klinës, por shtrenjtimi i materialeve, nuk është shtrenjtë për vendet e tjera por vetëm për Dresnik, por unë s'do ta përmend më, ama nëse unë në KKSB nuk mund ta paraqes problemin e rrugës e ky zotëria s'më lejon që të hyj te Kryetari.

Z.Shemsi Bajraktari: Qe pesë vite që jam te zyra e kryetarit, ke qenë përmbi pesëdhjetë herë, të premtën ka qenë në takim me zyrtarët e ministrisë dhe të kam thënë zotëri bëje terminin.

Z.Josip Dedaj: Shumë e vërtetë që kam pasur takime, por kam pasur takime nga halli, tridhjetë herë kam qenë për fabrikën e çimentos që jeni tu dashtë me qu peshë, por s'dojmë me hy në atë pjesë, e dyta kam pasur takime për fshatin tim, se jam përfaqësues dhe kam të drejtë me ardhur kur qytetarët më dërgojnë në takim me kryetarin, faleminderit.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit ty Josip. A ka dikush tjetër diçka?

Z.Fitim Bojaj, hoxhë: Vetëm për ta zbutur pak situatën, unë jam anëtar në KKSB prej 2003-ës dhe Josipi e ka një dekadë që është pjesë e KKSB-së dhe çdo herë ka qenë aktiv, ti Nënkrjetare një përgjigje e dhe që KKSB-ja është për siguri në bashkësi. Nëse kërkesa jonë e të gjithë anëtarëve dhe që bisedohet çdo mbledhje rruga e Dresnikut, nëse varet nga ne, ne të

gjithë po e bëjmë një kërkesë të përbashkët dhe po ju drejtohem Kuvendit Komunal edhe mos me qenë më ky si problem.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, kështu edhe veprohet dhe unë jo për ta zbutur ose për ta zbehur këtë që e the, se interesi ynë është jo më i madh se i atij, por kjo çështje është duke u diskutuar dhe do të diskutohet prapë, por herën tjetër me shkrim do ta sjell përgjigjen e jo fjalë. Të gjithë i kuptojmë debatet dhe jam mësuar me debate, nuk është problem, jo në politikë por në jetën e përditshme me Josipin njihemi shumë gjatë, ku na bën me qenë edhe më të lirë. Rrugica e Dresnikut është shndërruar në kërkesën më të madhe, tash po duket e gjithë qytetarëve, kështu që bashkë jemi.Po, urdhëro, znj. Silvia?

Znj.Silvia Rashkoviq: Përshëndetje për të gjithë, me vjen keq që nuk qenka Komandanti, desha të them diçka në aspektin e sigurisë, duke e ditur problemin në lidhje me tabelat e veturave ne këtu kemi të kthyer të cilët përdorin vetura me tabela të Serbisë, nuk kemi tabela të qyteteve të Kosovës por problem është që shumë qytetarë nuk po arrijnë ta bëjnë dallimin, ne nuk po e paraqesim se kemi ndonjë problem por e lus policinë që të kenë kujdes në disa fshatra t'i vizitojnë derisa të kalojë ky problem, faleminderit.

Zv.kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit Silvia e the edhe vet, mungesa e Komandantit na hendikepon për sa i përket sigurisë, por një përgjigje e kam edhe unë sipas mediave, sipas udhëzimit që është dhënë në fillim shkon me vërejtje është një periudhë e caktuar një muaj më duket, pastaj është pjesa tjetër prapë vërejtje dhe merren masa pak më të buta, deri në prill është ajo situatë, ku mandej do të procedohen. Siliva, ti e ceke që është problem politik dhe s'ka të bëjë me nivelin Komunal, si bëhet për gjithë Kosovën do të veprojmë edhe ne si Komunë, faleminderit.

Nënkryetarja e mbylli takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje.

Procesmbajtësja,

Orgeta Sylaj

ZV.KRYESUESJA,

Marqe Tanushi-Selmanaj



